



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E INSPEKTIMIT DHE MBIKËQYRJES**

Nr. 130/5 prot.

Tiranë, më 5.5.2025

**V E N D I M**

Nr.21 datë 5.5.2025

**MBI PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VLERËSIMIT TË LIGJSHMËRISË TË  
VEPRIMEVE ADMINISTRATIVE TË KRYERA NGA ORGANET E  
NGARKUARA NGA LIGJI, GJATË PROCESIT TË ECURISË DISIPLINORE, NË  
INSTITUCIONIN E BASHKISË TROPOJË**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit, e ndryshuar, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në përfundim të verifikimit të veprimeve administrative të kryera gjatë zhvillimit të ecurisë disiplinore ndaj nëpunëses Fitore Danaj, në institucionin e Bashkisë Tropojë,

**VËREJ SE:**

Pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, është regjistruar informacioni me shkresat nr. 130 prot., datë 10.2.2025 dhe nr. 130/2 prot., datë 11.3.2025, të dërguara nga nëpunësja Fitore Danaj, me detyrë “Specialiste e Ndihmës Ekonomike”, njësia administrative Bytyç, pranë Bashkisë Tropojë, në të cilin ngrihen pretendime për parregullsi të lejuara në zbatim të legjislacionit të shërbimit civil, gjatë procedurës së ecurisë disiplinore të nisur në ngarkim të saj, në përfundim të së cilës është dhënë masa disiplinore “Largim nga shërbimi civil”.

Konkretisht, në përmbajtje të informacionit dhe të dokumentacionit të administruar bashkëlidhur tij, parashtrohet se, gjatë kohës që trajtohej me raport mjekësor, në ngarkim të nëpunëses Fitore Danaj ka filluar ecuria disiplinore dhe në përfundim të procesit është

dhënë masa disiplinore “*Largim nga shërbimi civil*”, me motivacionin: mungesë e pajustificuar dhe braktisje e vendit të punës për më shumë se 1 muaj, duke sjellë pasoja shumë të rënda në përmbushjen e detyrave të caktuara, e klasifikuar sipas pikës 2, germa ç, të nenit 57, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, në shkelje shumë të rënda.

Në informacionin e dërguar nga nëpunësja, parashtrohet se, njësia administrative Bytyç nëpërmjet shkresës nr. 137/1 prot., datë 27.11.2024, i ka dërguar informacion Sektorit të Burimeve Njerëzore, në Bashkinë Tropojë, në përmbajtje të së cilit rezulton se, nëpunësja F. Danaj, nuk është paraqitur në punë nga data 4.11.2024, deri në datën 27.11.2024.

Në vijim të këtij njoftimi, me shkresën nr. 5495/3 prot., datë 9.1.2025, Komisioni Disiplinor, përmes Sektorit të Burimeve Njerëzore ka njoftuar nëpunësen për fillimin e ecures disiplinore, për shkak të kryerjes së shkeljeve të klasifikuara shumë të rënda, të cilat kanë sjellë pasoja në mbarëvajtjen dhe mirëfunksionimin e institucionit.

Në përfundim të procedurës disiplinore, Komisioni Disiplinor, me vendimin nr. 5, datë 24.1.2025, ka vendosur dhënien e masës disiplinore, “*Largim nga shërbimi civil*”, në ngarkim të nëpunëses Fitore Danaj.

Sa më lart, nëpunësja pretendon se, akti për dhënien e masës disiplinore është nxjerrë në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore që rregullojnë këtë institut të ligjit, pasi procesi i ecures disiplinore në ngarkim të saj, është zhvilluar gjatë kohës që nëpunësja ka qënë në pamundësi shëndetësore për tu paraqitur përpara Komisionit Disiplinor, fakt i cili nuk është marrë në konsideratë gjatë shqyrtimit disiplinor nga ky organ.

Në këto kushte, nëpunësja ka kërkuar ndërhyrjen e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për verifikimin dhe vlerësimin e ligjshmërisë së veprimeve të kryera nga ana e subjekteve të ngarkuara prej ligjit, me detyra specifike gjatë aplikimit të institutit të disiplinës në shërbimin civil.

Me qëllim verifikimin e rastit, me marrjen e këtij informacioni, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, bazuar në pikën 1, të nenit 14, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*” i ndryshuar, me shkresën nr. 130/1 prot., datë 24.2.2025 “*Kërkesë për dokumentacion në lidhje me verifikimin e informacionit të regjistruar me nr. 130 prot., datë 10.02.2025*”, ka vënë në dijeni institucionin për fillimin e verifikimit të kësaj procedure disiplinore, si dhe ka kërkuar dokumentacionin në të cilin është materializuar ajo.

Në përgjigje të kësaj kërke, institucioni i Bashkisë Tropojë me shkresën nr. 1065/1 prot., datë 7.3.2025, me objekt: “*Kthim Përgjigje*”, protokolluar pranë Komisionerit me shkresën nr. 130/3 prot., datë 13.3.2025, ka dërguar dokumentacionin e plotë në të cilin materializohet procedura disiplinore e ndjekur në këtë rast.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit që pasqyron veprimet administrative që janë kryer gjatë këtij procedimi disiplinor, që nga momenti i konstatimit të shkeljes disiplinore deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga organi disiplinor, rezulton se:

Nëpunëses Fitore Danaj, me aktin nr. 4539/6 prot., datë 27.12.2017, të Kryetarit të Bashkisë Tropojë, i është deklaruar statusi si “*nëpunës civil*”, në pozicionin e punës “*Specialiste për Auditin e Brendshëm*”, në Sektorin e Auditit të Brendshëm, pranë Bashkisë Tropojë.

Në vijim të marrëdhënies së punësimit, me urdhrin nr. 100, (nr. 1325 prot.), datë 13.3.2024, të Kryetarit të Bashkisë, është transferuar përkohësisht për nevoja të institucionit në pozicionin “*Specialiste e Ndhmës Ekonomike, Paaftësisë dhe Invaliditetit*”, në njësinë administrative Bytyç, Bashkia Tropojë.

Pas transferimit të nëpunëses, njësia administrative Bytyç, me shkresën nr. 137/1 prot., datë 27.11.2024, dërguar Sektorit të Burimeve Njerëzore, në Bashkinë Tropojë, ka informuar njësinë përgjegjëse se, nëpunësja F. Danaj, për periudhën 4.11.2024 - 27.11.2024, nuk është paraqitur në punë, në mënyrë të pajustificuar, (fakt ky i provuar edhe në listpagesat e institucionit).

Me marrjen e këtij informacioni, Bashkia Tropojë me shkresën nr. 4991 prot., datë 4.12.2024, dërguar Drejtorisë Vendore për Kufirin dhe Migracionin Kukës, ka kërkuar informacion nga sistemi TIMS, në lidhje me lëvizjet e nëpunëses Fitore Danaj, nisur edhe nga të dhënat e marra në rrugë jo zyrtare, se nëpunësja ka dalë jashtë territorit të Shqipërisë. Në përgjigje të kësaj kërkesë, Drejtoria Vendore për Kufirin dhe Migracionin Kukës, me shkresën nr. 1709/1 prot., datë 16.12.2024, ka sqaruar se, pas verifikimit kufitar në sistem TIMS, për hyrje- daljet nga Republika e Shqipërisë, të shtetases Fitore Danaj, rezulton se, kjo shtetase ka dalë nga Republika e Shqipërisë në datën 11.11.2024 dhe nuk rezulton të ketë hyrje në Republikën e Shqipërisë që nga ajo datë.

Nisur nga ky informacion, në mbështetje të neneve 57-59, të ligjit nr. 152/2013, i ndryshuar, si dhe VKM-së nr. 115, datë 5.3.2014, me anë të Urdhrit nr. 406, (nr. 5499 prot.), datë 31.12.2024, “*Për ngritjen e Komisionit Disiplinor për shqyrtimin e ecurisë disiplinore ndaj znj. Fitore Danaj*”, Zv/Kryetari i Bashkisë ka urdhëruar ngritjen e Komisionit të Disiplinës për shqyrtimin e ecurisë disiplinore ndaj nëpunëses F. Danaj, me përbërje si më poshtë vijon:

1. Shkurte Gjoka – Kryetar Komisioni Disiplinor, Përgjegjëse e Sektorit të Ndhmës Ekonomike;
2. Aurela Prozellomi – Anëtar, Specialiste e Ndhmës Ekonomike;
3. Hazir Isufaj – Anëtar, Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit;
4. Klodjana Aliaj – Anëtar, Përgjegjëse e Sektorit të Burimeve Njerëzore;
5. Sanie Sulaj – Anëtar, Inspektore e Shërbimeve Publike dhe Mjedisit;

Sa i takon përbërjes së këtij organi, sipas akteve të deklaramit të statusit të punësimit, rezulton se, të gjithë anëtarët e Komisionit Disiplinor janë nëpunës civil, të emëruar në pozicionet e punës të evidentuara si më poshtë:

1. Shkurte Gjoka, me aktin nr. 5008/40 prot., datë 12.1.2024, të Kryetarit, i është deklaruar statusi si “nëpunës civil”, në pozicionin “Përgjegjëse e Sektorit të Ndihmës Ekonomike”, Bashkia Tropojë;
2. Aurela Prozlomi, me aktin nr. 1680 prot., datë 20.4.2016, të Kryetarit, i është deklaruar statusi si “nëpunës civil”, në pozicionin “Specialiste e Ndihmës Ekonomike”, njësia administrative Tropojë;
3. Hazir Isufaj, me aktin nr. 4968 prot., datë 18.12.2020, të Kryetarit, i është deklaruar statusi si “nëpunës civil”, në pozicionin “Drejtore të Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit”, Bashkia Tropojë;
4. Klodjana Aliaj, me aktin nr. 4969 prot., datë 18.12.2020, të Kryetarit, i është deklaruar statusi si “nëpunës civil”, në pozicionin “Përgjegjëse e Sektorit të Burimeve Njerëzore”, Bashkia Tropojë;
5. Sanie Sulaj, me vendimin nr. 10, datë 30.6.2008, të Kryetarit, i është deklaruar statusi si “nëpunës civil”, në pozicionin “Inspektore të Shërbimeve Publike dhe Mjedisit”, në Sektorin e Punëve Publike, Mjedisit dhe Transportit pranë Bashkisë Bajram Curri.

Sipas kërkesave të pikës 3, të kreut I, të VKM-së nr. 115, datë 5.3.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, parashikohet se, Komisioni i Disiplinës duhet të ketë këtë përbërje:

- a) nëpunësi më i lartë civil në institucion, Kryetar;
- b) eprori direkt i nëpunësit civil për të cilin ka nisur ecuria disiplinore;
- c) drejtuesi i njësisë përgjegjëse për atë institucion;
- d) nëpunësi më i vjetër civil i institucionit ku punon nëpunësi për të cilin ka nisur ecuria disiplinore;
- e) nëpunësi më i vjetër civil i njësisë ku punon nëpunësi për të cilin ka nisur ecuria disiplinore.

Sa më lart, referuar përmbajtjes së urdhrit nr. 406, (nr.5499 prot.), datë 31.12.2024, të Zv/Kryetarit të Bashkisë, rezulton se, janë përcaktuar kryetari dhe anëtarët e këtij organi disiplinor, por, referuar akteve të deklaramit të statusit, konstatohet se, pozicionimi i tyre në këtë organ është i gabuar, nisur nga hierarkia administrative e pozicioneve të punës.

Konkretisht, si Kryetar i Komisionit të Disiplinës, në respektim të pikës II/B, të udhëzimit nr. 1, datë 2.4.2014, të DAP, paraqitet nëpunësi më i lartë civil në institucionin ku ka nisur ecuria disiplinore, që në rastin në fjalë, duhet të përkonte me anëtarin që mban pozicionin “Drejtore Drejtorie”.

Gjithashtu, edhe renditja e anëtarëve të KD, nuk është sipas kërkesave të udhëzimit.

Megjithëse këto parregullsi në përmbajtjen e urdhrit për ngritjen e organit të disiplinës, nuk janë të asaj natyre që të sjellin pavlefshmëri të procesit, ato duhet të mbahen në vëmendje nga palët procedurale, pasi janë kërkesa që rrjedhin nga një akt nënligjor, i cili parashikon procedurën disiplinore që duhet të aplikohet në këto raste.

Në vijim të zhvillimit të ecurisë disiplinore, zv/Kryetari i Bashkisë, nëpërmjet shkresës nr. 5499/1 prot., datë 6.1.2025, drejtuar Komisionit Disiplinor, ka kërkuar fillimin e procedurës për shqyrtimin e shkeljeve dhe dhënien e masës disiplinore për nëpunësen Fitore Danaj, me motivacionin: *“mungesë e pajustificuar dhe braktisje e vendit të punës për më shumë se 1 muaj” duke sjellë pasoja shumë të rënda në përmbushjen e detyrave të caktuara*, e klasifikuar sipas pikës 2, germa ç, të nenit 57, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, në shkelje shumë të rënda të disiplinës në shërbimin civil.

Në përputhje me kompetencat, organizimin dhe funksionimin e Komisionit Disiplinor, të përcaktuara në pikën II/A, të Udhëzimit nr. 1, datë 2.4.2014, *“Për elementet kryesore procedurale dhe materiale të ecurisë dhe shqyrtimit të shkeljeve disiplinore”*, të DAP, rezulton se ky organ sipas procesverbalit nr. 5499/2 prot., datë 9.1.2025, është mbledhur për të shqyrtuar kërkesën për nisjen e ecurisë disiplinore, duke evidentuar shkeljet e kryera nga nëpunësja, ndër të cilat:

- Braktisja e vendit të punës dhe mungesa të pasjustifikuara në punë për më shumë se 7 ditë, si pasojë ka ardhur mospërmbushja e detyrave të saj funksionale.
- Largimi nga territori i Republikës së Shqipërisë, faktuar me shkresën nr. 1709/1 prot., datë 16.12.2024, të Drejtorisë Vendore për Kufirin dhe Migracionin Kukës, pa leje të institucionit.

Gjithashtu, në këtë procesverbal Komisioni i Disiplinës ka marrë në konsideratë edhe faktin se, në raportin mjekësor të paraqitur nga nëpunësja, regjistruar me nr. regjistri 103, datë 23.12.2024, përcaktohet se, paaftësia për punë fillon në datë 3.11.2024 dhe bëhet i aftë për punë në datë 3.12.2024. Mirëpo, rezulton se, raporti mjekësor është gjeneruar në sistem pas 50 ditëve nga data e fillimit të paaftësisë, për këtë arsye, për konfirmimin e vërtetësisë së tij, institucioni i është drejtuar zyrtarisht Sigurimeve Shoqërore, Dega Tropojë me shkresën nr. 316 prot., datë 15.1.2025.

Në përgjigje të kësaj kërkesë, Dega e Sigurimeve Shoqërore Tropojë, Sektori i Përfitimeve, me shkresën nr. 223/1 prot., datë 5.2.2025, dërguar Bashkisë Tropojë, ka informuar këtë të fundit se:

*“Pas vizitës tek mjeku i familjes në datë 05.11.2024, znj. Fitore Danaj është paraqitur tek mjeku specialist, verifikimi në regjistër nr. rendor 103, datë 07.11.2024. Mjeku specialist ka dhënë raport, i cili është regjistruar në sistem në datë 23.12.2024, për periudhën 03.11.2024-03.12.2024, lëshimi i raportit me vonesë në sistem nuk justifikohet nga punonjësja e IT të spitalit, për më tepër, në sistem ka rezultuar se, kjo shtetase më datë 11.11.2024 është jashtë vendit, duke qenë se ky fakt, përbën shkelje për lëshimin e raportit mjekësor, punonjësja e IT ka refuzuar firmën.”*

Sipas Rregullores së miratuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, me nr.4360/1, datë 22.6.2022 “*Për kriteret, rregullat dhe procedurat e lëshimit të raporteve mjekësore elektronike për paaftësinë e përkohshme për punë, për barrë lindje dhe për aksidente në punë e sëmundje profesionale*”, e ndryshuar, në nenin 7, të saj parashikohet procedura që duhet të ndiqet për kurim jashtë vendit, duke përcaktuar se raporti mjekësor për paaftësi të përkohshme në punë të të sëmurëve që mjekohen jashtë Republikës së Shqipërisë, lëshohet nga Komisioni i Qendrës Spitalore Universitare, duke përcaktuar edhe aspektin procedural të lëshimit dhe afateve të përcaktuara. Në rastin konkret nuk janë ndjekur këto kërkesa, ashtu sikurse e saktëson edhe Dega e Sigurimeve Shoqërore Tropojë, në shkresën e dërguar, ç’ka nuk e provon faktin që punonjësja në fjalë të jetë larguar për kurim jashtë vendit.

Në këto kushte, seanca dëgjimore është caktuar në datën 17.1.2025, ora 10:00, nëpërmjet shkresës nr.5499/3 prot., datë 9.1.2025 “*Njoftim për fillimin e ecuresë disiplinore ndaj znj. Fitore Danaj*” të Kryetarit të Komisionit Disiplinor, duke njoftuar për këtë fakt Sektorin e Burimeve Njerëzore, të Bashkisë Tropojë dhe duke i lënë si detyrë, njoftimin e nëpunëses për fillimin e ecuresë disiplinore në ngarkim të saj.

Me shkresën e Zv/Kryetarit të Bashkisë, nr. 5499/4 prot., datë 9.1.2025 “*Njoftim për fillimin e procedurës disiplinore*”, është njoftuar nëpunësja, për fillimin e ecuresë disiplinore për shkelje shumë të rënda të disiplinës në shërbimin civil, duke i dhënë mundësinë për paraqitjen e pretendimeve dhe sqarimeve përkatëse në seancën e datës 17.1.2025, ora 10:00, mbajtur në zyrën e Këshillit të Bashkisë. Referuar procedurës së ndjekur nga Komisioni Disiplinor, rezulton se, janë respektuar kërkesat e parashikuara në pikën B/2, të kreut II, të udhëzimit nr. 1, datë 2.4.2014, të DAP, sa i takon procedurës, elementeve dhe afatit që duhet të përmbajë akti i njoftimit të nëpunëses për të cilën ka filluar ecuria disiplinore, ku parashikohet se, seanca dëgjimore nuk mund të zhvillohet më shpejt se 4 (katër) ditë dhe jo më vonë se 16 (gjashtëmbëdhjetë) ditë nga marrja e njoftimit. Gjithashtu, në aktin e njoftimit është përcaktuar shkelja disiplinore e pretenduar, e drejta për tu dëgjuar dhe paraqitur fakte nga nëpunësja në procedim etj.

Komisioni Disiplinor është mbledhur në seancën dëgjimore të caktuar, faktuar me procesverbalin nr. 5499/5 prot., 17.1.2025, por ka konstatuar se, nëpunësja edhe pse ka marrë njoftim nuk është paraqitur në seancë, e për këtë arsye ka vendosur shtyrjen e seancës në datën 23.1.2025, ora 10:00.

Me shkresën nr. 5499/6 prot., datë 17.1.2025 “*Rinjoftim për fillimin e procedurës disiplinore*”, të Zv/Kryetarit të Bashkisë, është njoftuar përsëri nëpunësja F. Danaj, për datën e seancës së re dëgjimore.

Pas marrjes së njoftimit të dytë, në datën 21.1.2025, nëpunësja ka njoftuar institucionin se nuk mund të paraqitet në seancë, pasi ndodhet në regjim shtrati, fakt për të cilin nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion justifikues.

Sipas procesverbalit me nr. 5499/8 prot., datë 23.1.2025, Komisioni i Disiplinës është mbledhur në seancën e caktuar, ndërkohë që, nëpunësja nuk është paraqitur, pa pasur një arsye të përligjur, edhe pse ka marrë njoftim.

Në përputhje me kërkesat e pikës 4, të germës C, kreu II, të udhëzimit të DAP, Komisioni i Disiplinës, ka hetuar arsyen e mosparaqitjes së nëpunëses në dy seancat dëgjimore, duke arritur në konkluzionin se, nuk ka patur një arsye të përligjur, të mbështetur në dokumentacion për justifikimin e mosparaqitjes së saj.

Pas kryerjes së veprimeve të evidentuara më lart, si dhe pas shqyrtimit të gjithë dokumentacionit të administruar gjatë të gjithë procedurës së ecursë disiplinore, Komisioni Disiplinor, me vendimin nr. 5, (nr. 5499/9), datë 24.1.2025, ka konstatuar se, nëpunësja F. Danaj në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*” dhe Rregulloren e Brendshme të institucionit, nuk ka kryer detyrat funksionale, për shkak të largimit në mënyrë të pajustificuar nga vendi i punës për më shumë se 1 muaj, duke sjellë pasoja të rënda për veprimtarinë e institucionit, fakt i reflektuar edhe në ankesat e ardhura nga qytetarët (*përfitues të ndihmës ekonomike*) në këtë njësi.

Për këto arsye, Komisioni i Disiplinës ka vendosur dhënien e masës disiplinore “*Largim nga shërbimi civil*”, për nëpunësen Fitore Danaj, me detyrë “*Specialiste e Ndihmës Ekonomike dhe PAK*”, njësia administrative Bytyç, Bashkia Tropojë, duke i njohur të drejtën e ankimit të vendimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër brenda afatit ligjor të përcaktuar.

Në zbatim të vendimit të Komisionit të Disiplinës, me vendimin nr. 5/1, (nr. 5499/10 prot.), datë 4.2.2025 “*Për largimin nga shërbimi civil si masë disiplinore të nëpunëses civile nj. Fitore Danaj*”, të Zv/Kryetarit, është vendosur përfundimi i marrëdhënies së punës, për nëpunësen Fitore Danaj, me detyrë “*Specialiste e Ndihmës Ekonomike dhe PAK*”, njësia administrative Bytyç, për shkelje shumë të rënda të disiplinës në shërbimin civil.

Nisur nga përmbajtja e dokumentacionit në të cilin materializohet procedura disiplinore e ndjekur në këtë rast, Komisioneri arrin në konkluzionin se, nga pikëpamja procedurale janë respektuar të gjitha kërkesat e ligjit, duke filluar nga momenti i konstatimit të shkeljes disiplinore; kategorizimit të saj nga eprori direkt dhe kërkesa për fillimin e ecursë; fillimi i ecursë disiplinore nga KD dhe vënia në dijeni për këtë fakt të nëpunëses që pretendohet se

ka kryer shkeljen; respektimi i të drejtës për t'u dëgjuar e për t'u mbrojtur dhe administrimi i provave materiale të nevojshme, e deri në marrjen e vendimit përfundimtar nr. 5, (nr.5499/9 prot.), datë 24.1.2025, të Komisionit të Disiplinës, për dhënien e masës disiplinore *“Largim nga shërbimi civil”*, për nëpunësen Fitore Danaj dhe ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me aktin nr. 05/1, (nr. 5499/10 prot.), datë 4.2.2025, të Zv/Kryetarit.

### **Për këtë arsye:**

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar; të nenit 90, pika 2, të ligjit nr.44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, i ndryshuar; si dhe në mbështetje të nenit 16, pika 6, e Rregullores *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, e ndryshuar,

### **VENDOSA:**

1. Përfundimin e hetimit administrativ dhe arkivimin e çështjes së nisur kryesisht në bazë të informacionit të regjistruar pranë Komisionerit me shkresat nr. 130 prot., datë 10.2.2025 dhe nr. 130/2 prot., datë 11.3.2025, të paraqitura nga nëpunësja Fitore Danaj, me objekt vlerësimin e ligjshmërisë së veprimeve administrative të kryera gjatë procesit të ecurisë disiplinore, në përfundim të së cilit është dhënë masa disiplinore *“Largim nga shërbimi civil”*, në ngarkim të saj, në kushtet kur në veprimet e kryera nga organi kompetent eprori direkt dhe Komisioni i Disiplinës, nuk konstatohen elementë që vijnë në kundërshtim me legjislacionin e shërbimit civil.
2. Të njoftohet për këtë vendim Bashkia Tropojë dhe nëpunësja Fitore Danaj.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**